

Falja e namazit përmbas atij që e ka *texhwidin* të dobët

“Namazi me xhemat” i shejh Sâlih es-Sedlân, f.144-146

Domethënia e *ummî* është ai që e ka recitimn të dobët në namaz, pavarësisht se me cilën pjesë të Kuranit kemi të bëjmë. Sipas Shafive dhe Hanbelive, kjo nënkupton atë që s’mund ta recitojë si duhet tërë el-Fatihanë; ai lë ndonjë shkronjë apo bën gabime gramatikore që ndryshojnë kuptimin.

S’ka dyshim që, ai cili reciton mirë, është më i denjë sesa ai që s’mund ta bëjë këtë, sidomos në rastin e udhëheqjes së namazit. Është obligim që vetëm ai i cili reciton si duhet të lejohet t’i udhëheqë njerëzit në namaz, siç tha dhe peygamberi ﷺ:

“Le t’i udhëheqë njerëzit në namaz më kompetenti ndër ta.” (Sahih Muslim)

Por, nëse udhëheq namazin dikush i cili një pjesë të recitimit të obligueshëm e ka të dobët, si do të jetë vendimi për namazin e atyre që falen përmbas tij sa i përket vlefshmërisë së namazit dhe nevojës për ta përsëritur atë? Juristët (fukahatë) kanë dalluar lidhur me këtë duke shprehur katër qëndrime:

Qëndrimi i parë: Namazi s’është i vlefshëm përmbas tij dhe, ai që udhëhiqet, duhet ta përsërisë namazin. Ky ishte qëndrimi i Ebu Hanifes, i Malikut, i Shafiut dhe i Ahmedit. Prova gjendet në thënien e tij:

“S’ka namaz për atë që nuk e reciton Çeljen e Librit (el-Fatihanë).” (Buhari & Muslim)

Ky hadith provon që leximi i sures el-Fatiha është obligim. Kushdo që është i dobët në recitimn e el-Fatijasë, nuk konsiderohet të ketë recituar në mënyrë të plotë. Prandaj, kush falet përmbas tij, duhet ta përsërisë namazin e tij.

Qëndrimi i dytë: Namazi përmbas tij është i lejueshëm. Meqë është i lejueshëm, atëherë s’është e domosdoshme të përsëritet namazi. Ky është qëndrimi i Atâ ibn ebî Rebahut, i Katades, i el-Muzenit, i Ebu Theur dhe i Ibn el-Mundhir.

Ata arsyetuan se ai nuk është në gjendje të përmbushë një shtyllë të namazit dhe është e lejueshme të falesh përmbas tij mu si në rastin ku ndjekësi falet përmbas një imami që s'mund të rrijë në këmbë.

Qëndrimi i tretë: Është e lejueshme për recituesin e Kuranit të falet përmbas atij që s'mund të recitojë si duhet në namazet që falen pa zë, por jo dhe në ato ku namazi falet zëshëm. Ky është një qëndrim i përcjellë nga shkollat Shafite dhe Hanbelite.

Ata arsyetuan që (në namazet pa zë) secili është i urdhëruar të recitojë në vetvete, prandaj namazi i tyre është i vlefshëm dhe s'ka nevojë që ai të përsëritet.

Qëndrimi i katërt: Nëse personi që s'mund të recitojë si duhet udhëheqë ata të cilët, po ashtu, s'mund të recitojnë si duhet, namazi i tyre është i vlefshëm. Ky është qëndrimi i zgjedhur i shkollës Hanbelite.

Nëse ai që s'mund të recitojë si duhet i udhëheq ata të cilët nuk mund të recitojnë si duhet si dhe ata të cilët mund të recitojnë si duhet, atëherë namazi i atyre që s'mund të recitojnë si duhet është i vlefshëm, kurse namazi i atyre që mund të recitojnë si duhet s'është i vlefshëm dhe duhet të përsëritet.

Nëse një person që s'mund të recitojë si duhet udhëheq në namaz një tjetër që mund të recitojë, namazi i të dyve është i pavlefshëm dhe duhet të përsëritet. Kjo ngaqë ai që s'mund të recitojë si duhet pati për qëllim të udhëheqë ndërsa, në fakt, ai u fal i vetëm.

Qëndrimi më i fortë: qëndrimi më i fortë është i katërti, por duhet të plotësohen disa kushte:

1. Nuk është e lejueshme të caktohet imam i përhershëm dikush që s'mund të recitojë, kur ka person tjetër në xhemat që mund të recitojë
2. Nuk është e lejueshme për recituesin të nisë namazin e tij ndërsa udhëhiqet nga dikush që s'mund të recitojë si duhet

3. Nëse ai që mund të recitojë udhëhiqet nga dikush që s'mund të recitojë ndërsa nuk e di gjendjen e tij, namazi i tij është i vlefshëm, për shkak të përgjithësisë së thënies së tij صلى الله عليه وسلم:

“Faluni përmbas kujtdo që thotë s’ka të denjë për adhurim pos Allahut (la ilahe ila-Allah).”